



Sigurimi i Jetës për Kreditë Konsumatore të Pasiguruara

Sigurimi i jetës së debitorit mbron kredimarrësin kur shlyerja e kredisë bëhet e pamundur për shkak të paaftësisë së plotë e të përhershme si rrjedhojë nga aksidenti ose për shkak të humbjes së jetës. Shoqëria e sigurimit do t'i paguajë bankës, detyrimet e mbetura për kredinë e përcaktuar.

Karakteristikat e Sigurimit të jetës së debitorit:

Sigurimi i jetës së debitorit ofrohet për klientët individ që janë të interesuar të sigurojnë kreditë konsumatore të pasigururara, në rastet e paaftësisë së plotë të përhershme nga aksidenti ose humbjes së jetës brenda periudhës së kredisë dhe Shoqëria e Sigurimit do të paguajë pjesën e pashlyer të kredisë.

I Siguruari është kredimarrës i cili ka marrë kredi konsumatore të pasigururuar pranë Alpha Bank nga mosha 18 - 70 vjeç.

Shuma e sigurimit është shuma e kredisë deri në 2,000,000 lekë.

Ngjarjet që sigurohen

- Humbja e Jetës
- Humbja Aksidentale e Jetës
- Paaftësisë të plotë të përhershme nga aksident

Primi i sigurimit 2% e shumës së kredisë paguhet në fillim të kredisë për të gjithë kohëzgjatjen.

Kohëzgjatja e policës së sigurimit është për të gjithë periudhën e kredisë, deri në 84 muaj.

Dëmshpërblimi paguhet në vlerë monetare nga Kompania e Sigurimit me vërtetimi e ngjarjes së siguruar.

Përfitimi i pagueshëm - Shuma e mbetur e kredisë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, sipas tabelës së amortizimit të kredisë.

Individë që nuk sigurohen:

- Bashkë kredimarrësit e tjerë të përfshirë në kredinë konsumatore (kur nuk kërkohet ndryshe)
- Ristrukturimin e kredisë së siguruar duke i ndryshuar afatin & kohëzgjatjen, sjell shfuqizimin e policës ekzistuese
- Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoja, sindroma organiko-cerebrale;
- Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm;
- Individë mbi 70 vjeç dhe Individë më të rinj se 18 vjeç.

Njoftimi i ngjarjes duhet të kryhet me shkrim brenda **30 ditësh** nga data që Policëmbajtësi merr dijeni për ngjarjen.